

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti përgjithshëm penal, duke vendosur sipas gjyqtarit Skender Shefkiu me asistenten Ajshe Bekteshi në çështjen penale të akuzuarit F.K nga, K. Kaqanikut për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragraf 1 të KPRK-së, e sipas aktakuzave të PTHSH nga Gjilani, PP.II.nr.983/2015, të datës 18.06.2015, të përfaqësuar nga L.K, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më 11.01.2017 shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F.K. nga babai H dhe nenes K, e vajzerise, i lindur me “data e lindjes...”, ne K..., ku dhe jetonë, me nr. personal letërnjoftimi . . ., ka te kryer shkollen mesme, i pa pune, i martuar, babe 2 fëmijeve, me gjendje te dobet ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikes Kosovës.

ËSHTË FAJTOR SEPSE

I. Më datë 04.05.2015, rreth orës 11:20, në fshatin G. të komunës së V, në pyellin shtetëror, në vendin e quajtur “V . T” me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 60 trungje të njoma të shkozës me diametër në cung 11-13cm, në lartësi, me lartësinë (gjatësinë) e drurit 5m, dhe me vëllim të përgjithshëm prej 4.20m³, i cili nga vendi i cekur deri në rrugë kryesore i transportonte me gomar-mushk, vlera e të cilave ishte 567.00€ për të cilën shumë të të hollave ka dëmtuar **APK-zyra në Viti.**

Me çka ka kryer vepra penale, **vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së.**

-Andaj Gjykata në bazë të nenit 41, 45, 51, 73, 74, e 75 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së,

E G J Y K O N

Me dënim burgu në kohë zgjatje prej 90 ditësh.

Dënimi i shqiptuar nuk do të ekzekutohet **me KUSHT që brenda 1 viti** mos të kryej veper tjeter penale (koha e verifikimit).

Obligohet i akuzuari t’i paguajë Gjykatës shpenzimet e procedures penale në shumë **prej 20 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara Autoriteti Pyjor Komunal në Viti e Gjilan, për kerkesën pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTHSH nga Gjilani me aktakuz PP.II.nr.983/2015, të datës 18.06.2015, e ka akuzuar F.K. nga K. . . për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragraf 1 të KPRK-së.

Prokurorja L.K. : fjalën përfundimtare ka deklaruar: Mbetet në tërësi pranë aktakuzes të paraqitura dhe propozimeve që e njejta i permban pasi që gjendja faktike në këtë çështje penale juridike u vertetua edhe me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pranim ky që është në përputhshmeri të plotë edhe me provat tjera të cilat janë propozuar për tu shtjelluar si prova për ta vertetuar të drejtën në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit, t'i merren parasysh të gjitha rrethanat; si ato rënduese po ashtu edhe ato lehtësuese ndërsa në anën tjetër edhe faktin se i pandehuri ishte korrekt para gjykatës dhe e pranoi fajsinë.

Fjala përfundimtare të akuzuarit F.K.: ka kërkuar nga gjykata që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë, për veprën penale të cilen e ka kryer është penduar, është në gjendje të vështirë ekonomike, është mbajtës i familjes 4 anëtarëshe dhe me ndihma sociale, këto dru i kishte marrë për nevoja personale pasi nuk kishte mundësi për ti blerë me para, nuk do të përserisë me këtë vepër e as vepra të tjera penale, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin.

Gjykata pas vlersimit të provave që gjinden në shkresat e lëndës e pasi që i akuzuari ka pranuar në tërësi veprën penale, pranimin e fajësisë e cila është bërë në përputhje me dispozitat e nenit 246 të KPRK-ës, e që i vihet në barë Gjykata u përqendrua në vendosjen vetëm perkitazi mbi matjen dhe lartësin e dënimit konform nenit 74 i KPRK-es, dhe nenit 75 të KPK-es, kështu me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të këtij lloji e as të tjera, është hera parë që përballet me Ligjin dhe ka premtuar se tash e tutje nuk do të bie ndesh me ligjin, me gjendje të varfër ekonomike. Si rrethanë rënduese shkalla e përgjegjesisë penale dhe dëmi i shkaktuar Autoritetit Pyjor Komunal në Viti.

Bindja e Gjykatës së denimi i shqiptuar është i ligjshëm, është në proporcion me veprën penale, përgjegjësin penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e tillë të shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij denimi.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI

P.nr. 327/2015

Me dt.16.01.2017

**Asistentja,
Ajshe Bekteshi**

**G j y q t a r i,
Skender Shefkiu**

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të Aktgjykimit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate.